



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 10.9.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi, Nezir Çoçaj, Selvije Halimi, Agim Aliu, Doruntinë Maloku, Milena Miliqeviq dhe Danush Ademi.

Mungoi: Fatmir Limaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Florina Merovci-ZPRK; Blerta Bejtullahu EUSR/EU Office; Kaltrina Ahmeti GPLS; Leutrim Berisha-Tribuna Channel; Behlul Beka- EUSR/EU Office; Arton Demhasaj-ÇOHU; Artan Canhasi-KDI; Fjolla Uka-KDI; Valdete Berisha-Kosova Sot; Lejla Selimi-OSCE; Gresa Ramadani-vizitore; Basri Berisha-IAP; Ardian Bajraktari-MD dhe Hamit Mjeku-praktikant në Kuvend

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.6.2015;
3. Diskutim për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik;

4. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
5. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi;
6. Njoftim me shkresën e dërguar nga ZPD;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Pas hapjes së mbledhjes nga kryetarja e Komisionit, fjalën e kërkoi deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Donika Kadaj-Bujupi tha se ndihet e befasuar që me gjithë ndodhitë që kanë ndodhur këto ditë, nuk janë në rend dite marrëveshjet e arritura në Bruksel respektivisht në Vjenë. Marrëveshja e nënshkruar e që lidhet me demarkacionin dhe asociacionin, pa i përjashtuar edhe të tjerat, janë dy pika për të cilat konsideroj që Qeveria është dashtë që të sjell dokumentet përkatëse në këtë Parlament dhe këtë Komision, pasi që jemi Komisioni për Ligje dhe kemi obligim ti shqyrtojmë. Para se të vazhdohet debati në publik, ne në formën institucionale jemi të thirrur që ti kemi këtu, të thërrasim Qeverinë, sepse me nenin 18 të Kushtetutës obligohen që të njëjtat marrëveshje t'i sjellin për ratifikim në Kuvendin e Kosovës sepse deklaratat që dëgjohen nga Qeveria, se me një dekret do ti aprovojë dhe do t'ia japin formën ligjore këtyre marrëveshjeve është në kundërshtim me Kushtetutën. Andaj kërkoj që kjo të jetë pikë e parë e rendit të ditës, pra e marrëveshjeve të arritura dhe të dalim me rekomandime për Qeverinë.

Kryetarja tha se nuk është kjo çështje në rend dite, pikërisht për atë çfarë theksoi znj. Kadaj-Bujupi sepse Qeveria e ka përjashtuar Kuvendin në tërësi nga ky proces, në vend që të diskutonte në Kuvend, ku do ta bënte një rekapitullim të të gjithë procesit negociator, e njëjta pa kuruar konsultimi paraprak shkoi dhe diskutoi edhe për 4 (katër) marrëveshje të tjera. Me 26 gusht marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi, ku si qytetare, deputete dhe kryetare jam e shqetësuar me marrëveshjet që Qeveria ka nënshkruar në Bruksel, duke ditur faktin se me ato marrëveshje po tentohet të krijohet një organ ose pushtet i tretë në Republikën e Kosovës, ngjashëm siç është në Bosnje që është krijuar në vitin 1991-1992.

Armend Zemaj- Kërkoj nga kryetarja e Komisionit që të qes në votim rendin e ditës dhe të flitet për rendin e ditës.

Kryetarja theksoi se tani më janë lodhur duke dëgjuar nga Qeveria se marrëveshjet e arritura janë në përputhshmëri me Kushtetutën, mirëpo, nëse i shohim vetëm dy pikat për “zajednicën” dihet se është në shpërpushje të plotë me Kushtetutën, sepse vetëm Qeveria, Presidenti, deputetët dhe 10 mijë qytetarë kanë të drejtën e propozimit të Ligjeve në Kuvend kurse me marrëveshje i është dhënë e drejta edhe “zajednicës” që të propozojë ligje në Kuvend. Njëjtë edhe me rastin

pranë Gjykatës Kushtetuese, ku e kanë bërë si palë të autorizuar “zajedincën” që në rastet kur ka të bëjë me “zajednicën” ti drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pra po e shkel Ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjin për polici dhe një serë ligjesh tjera. Po thuhet se është asociacion, pa më thoni se cila OJQ sot në Kosovë e zgjedh komandantin regjional të Policisë? Cila OJQ ka shërbyes civilë? Cilës OJQ i delegohen kompetenca nga Qeveria?

Nuk mund të diskutojmë për Projektligjin, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik, kur e dimë se me çfarë shtate tjera po ballafaqohemi. Nuk arrestohesh sot për krim të organizuar dhe korrupsion as për tenderromani as për nepotizëm, sot arrestohesh pse shpërndan fletushka ose bënë mbishkrime të grafitëve.

Doruntinë Maloku- Kërkoj nga Kryetarja e Komisionit znj.Haxhiu që si kryetare e Komisionit të mos paraqes qëndrime politike të Lëvizjes Vetëvendosje, sepse si kryetare e Komisionit keni të drejtë ti paraqisni qëndrimet e Komisionit për legjislacion e assesi në asnjë mënyrë nuk guxoni ti paraqisni qëndrimet e VV-së, prandaj kërkoj që qëndrimet e VV-së ti paraqisni pas partive tjera ashtu siç i paraqesin në seanca plenare, do të thotë, në bazë të radhitjes së grupeve parlamentare. Nuk është etike si kryetare e Komisionit të flisni me një qëndrim politik të LVV-së që ju e përfaqësoni.

Kryetarja- Si deputete znj Maloku nuk keni të drejt që të më thoni se nuk guxoj sepse ajo në fakt çfarë nuk do duhet të bënte Komisioni është që nuk guxon të qëndrojë i heshtur karshi kësaj shtate. Sa i përket LVV-së, unë jam këtu kryetare e Komisionit për Legjislacion, por që përfaqësoj VV-në, dhe nuk do isha e tillë po të mos isha deputete e VV-së. Nuk është vetëm LVV-ja që ka kundërshtuar marrëveshjet e arritura por edhe shoqëria civile e besoj se edhe çdo qytetar i Kosovës është kundër këtyre marrëveshjeve.

Meqë nuk u diskutua për rendin e ditës, anëtarët e Komisionit lëshuan mbledhjen, me përjashtim të deputetëve Albulena Haxhiu dhe Donika Kadaj-Bujupi, kështu që Komisioni nuk kishte kuorum për të vazhduar mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,
Selvije Halimi
